

MENDIM PAKICE

Si anëtar i trupit gjykues nuk pajtohem me konkluzionet përfundimtare të arritura nga anëtarët e shumicës së trupit gjykues për konfirmimin në detyrë të subjekti i rivlerësimit, z. Artan Shtrungza, me arsyetimin që ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Ndërsa në lidhje me rivlerësimin e pasurisë dhe kontrollin e figurës, jam dakord me argumentet e përdorura nga ana e shumicës.

Për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Shtrungza, Prokuroria e Përgjithshme ka bërë vlerësimin profesional sipas nenit 43, të ligjit nr. 84/2016, dhe ka hartuar dhe paraqitur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit raportin nr. ***, datë 2.11.2018. Në këtë raport, Prokuroria e Përgjithshme ka evidentuar disa mangësi në aspektin e njohurive ligjore, e arsyetimit ligjor dhe e zbatimit të gabuar të ligjit.

Gjithashtu, trupi gjykues gjeti të tjera mangësi që nuk ishin pasqyruar në raportin e sjellë nga Prokuroria e Përgjithshme, por referuar një denoncimi të paraqitur pranë Komisionit për proçedimin nr. *** të vitit 2018, nga i cili konstatohet se ka disa mangësi në mënyrën e organizimit të punës për këtë proçedim.

Bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, çështjet e analizuar rezultuan me të meta. Këto të meta përsëriten nga njëra çështje tek tjetra dhe nuk janë rastësore por model pune i subjektit të rivlerësimit.

Nga analizimi i të dhënave të administruara gjatë hetimit: (i) raporti për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme; (ii) formulari i vetëdeklarimit, tre dokumente ligjore dhe dokumente të tjera të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhëna nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme; (v) informacione të tjera të marra nga burime të ligjshme; relacioni i relatores së çështjes dhe provave të mbledhura nga hetimi administrativ; (vi) informacione të marra nga denoncimet; (vii) shpjegime të provave të sjella nga subjekti i rivlerësimit, në lidhje me vlerësimin profesional; (viii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, **unë, si anëtarë në pakicë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nga ana profesionale ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët dhe nuk është efektiv në atë shkallë, sa rekomandoj një program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës për të plotësuar këto mangësi brenda një viti, për këto arsye:**

a. Mangësi në angazhimin profesional sipas nenit 76, të ligjit nr. 96/2016

1. Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur as edhe një angazhim në veprimtari të tjera, duke mos marrë pjesë: (i) në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës; (ii) trajnime të tjera profesionale; dhe (iii) veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, dhe veprimtari për marrëdhëniet me publikun të gjykatave dhe publikimet ligjore akademike. Kjo vërtetohet me anë të raportit të vlerësimit nr. ***, datë 2.11.2018, të dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Shtrungza; seksioni “Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit”, germa “d”, ku citohet : *“Prokurori Artan Shtrungza, subjekt rivlerësimi, nuk ka depozituar certifikata trajnimesh për tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës”*.

2. Fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka asnjë angazhim në fushën profesionale, nuk është në përputhje me parimin e përgjithshëm të vlerësimit të magjistratit për vendosjen e standardeve të qëndrueshme për cilësinë dhe sasinë e veprimtarisë së magjistratëve, pavarësisht vendit ku ushtrohet kjo detyrë.

3. Për më tepër, aftësia në angazhimin profesional është një nga burimet e vlerësimit profesional të një magjistrati, **përcaktuar në pikat 4 dhe 5, të nenit 76, të ligjit nr. 96/2016, ku përcaktohet:**

“4. Gatishmëria për t’u angazhuar në veprimtari të tjera matet duke u bazuar në tregues të tillë, si pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në trajnime të tjera profesionale, disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr magjistratët e ardhshëm gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e magjistratëve të rinj, pjesëmarrja e magjistratit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun të gjykatave dhe publikimet ligjore akademike.”

“5. Pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës matet duke u bazuar në informacionin e dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, në vlerësimin “shumë mirë” në rastet e përmbushjes së detyrimit ligjor për të marrë pjesë në formim vazhdues jo më shumë se 40 ditë në vit dhe jo më shumë se 200 ditë gjatë pesë vjetëve. Shkallët e tjera të vlerësimit përcaktohen me rend zbritës nga ky standard.”

b. Interpretimi i gabuar i ligjit, arsyetimi ligjor i gabuar, referenca të gabuara ligjore dhe dokumente me përmbajtje të pastrukturuar dhe me gabime gramatikore

1. Nga analizimi i procedimi penal nr. ***, datë 25.1.2014, të përzgjedhur me anë të shortit si dokumenti nr. 1, për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, për të cilin është vendosur pushimi i procedimit penal në datën 11.4.2014, unë, si anëtar në pakicë, konstatoj:

1.1 Në dokumentin ligjor të përgatitur nga ana e subjektit të rivlerësimit, vihet re se ai në pjesën konstatuese të vendimit shprehet se: *“Më datë 10.4.2014 ka hyrë në fuqi ligji nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”. Neni 5 i këtij ligji përcakton se “Amnistohen nga ndjekja penale të gjithë personat të cilët deri në datën 31 dhjetor 2013 kanë kryer vepra penale të cilat parashikojnë një dënim në maksimum deri në dy vjet burgim ose çdo lloj dënimi tjetër më të lehtë, me përjashtim të veprave të parashikuara në pikën nr. 2 të nenit 6 të këtij ligji.”*”

1.2 Subjekti i rivlerësimit bën një analizë të përcaktimeve ligjore të ligjit nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”, datë 10.3.2014, ku në nenin 5 të tij parashikohet: *“... amnistohen personat që deri në datën 31.12.2013 kanë kryer vepra penale, të cilat parashikojnë në maksimum dënim deri në dy vjet burgim ose dënim më të lehtë...”*, si dhe përcaktimeve të nenit 278/2 të Kodit Penal, ku parashikohet dënim me burgim deri në dy vjet. Subjekti i rivlerësimit analizon edhe përcaktimet e nenit 6/2, të ligjit nr. 22/2014, ku konstatohet se vepra penale e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal nuk përfshihet në veprat penale, të cilat kategorizohen si kriter jo-përfitues nga amnistia.

1.3 Në pjesën konkluduese subjekti ka vendosur të pushojë hetimet e procedimit penal me arsyetimin se vepra penale është amnistuar duke iu referuar germës “f”, të pikës 1, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale.

1.4 Nga aktet e dosjes hetimore rezulton se mbajta e paligjshme e municionit është konstatuar në datën 24.1.2014, ndërkohë që ligji i zbatuar nga subjekti për pushimin e çështjes është ai me nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”, neni 5, i cili i ka shtrirë efektet deri në datën 31.12.2013, pra, ka amnistuar të gjithë personat, të cilët deri në këtë datë kanë kryer vepra penale që parashikojnë në maksimum dënim deri në dy vjet burgim ose dënim më të lehtë.

1.5 Referuar në sa më lart, unë, si anëtar kundër, arrij në konkluzionin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka bërë arsyetim të gabuar në vendimin e pushimit;
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka bërë interpretim të gabuar të ligjit mbi amnistinë, si dhe kualifikim ligjor të gabuar, ku si pasojë ka ardhur marrja e një vendimi të gabuar.

1.6 Fakti që subjekti pranon vetë se kjo vendimmarrje është e pasaktë dhe e ka interpretuar gabim si ligjin për dhënie amnistie të vitit 2014, si dhe një udhëzim që ka ardhur në atë kohë nga Prokuroria e Përgjithshme në zbatim të ligjit, tregon se ky subjekt ka një nevojë të domosdoshme për t'u trajnuar në programin e Shkollës së Magjistraturës, në kushtet kur vetë subjekti ka punuar në një prokurori relativisht të vogël dhe nuk e ka kryer Shkollën e Magjistraturës.

1.7 **Në lidhje me vlerësimin e shumicës së trupit gjykues se:** *“Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka vendosur për pushimin e procedimit penal nr. ***/2014, jo në përputhje me parashikimit e ligjit “Për amnistinë”, por kjo vendimmarrje nuk mund të përbëjë shkak për shkarkimin e tij, gjithashtu nuk është tregues për mungesën e njohurive në lidhje me ligjin “Për amnistinë”, pasi në procedimin nr. ***/2013 ai e ka zbatuar saktë këtë ligj.”*, unë, si anëtar kundër, bie dakord me shumicën e trupit gjykues se kjo vendimmarrje nuk mund të përbëjë shkak për shkarkim, por nuk bie dakord me vlerësimin se: *“Gjithashtu nuk është tregues për mungesën e njohurive në lidhje me ligjin “Për amnistinë”, pasi në procedimin nr. ***/2013 ai e ka zbatuar saktë këtë ligj.”*, duke qenë se kemi një subjekt rivlerësimi, i cili nuk ka asnjë angazhim profesional jashtë zyrës së tij, duke mos plotësuar as detyrimin ligjor për të marrë pjesë në formimin vazhdues jo më shumë se 40 ditë në vit. Qëllimi i formimit vazhdues ose trajnimit juridik në Shkollën e Magjistraturës është një proces mësimi që vijon në mënyrë vazhduese, duke qenë pjesë e rritjes së gjithsecilit nga ana profesionale, kryesisht për ato subjekte rivlerësimi, të cilët nuk e kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës dhe nuk bëjnë pjesë në ato prokurori ku çështjet janë shumë komplekse.

1.8 Në lidhje me deklarin e subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore të datës 13.5.2019, seancë në të cilën ai deklaroi se: *“Vendimmarrja e gabuar ka qenë si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit, ardhur si pasojë e ngarkesës së madhe në punë në atë kohë...”*, unë, si anëtar kundër, vlerësoj se ky shkak i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nuk mund të mbizotërojë mbi interpretimin e gabuar të ligjit, pasi pasojat do të jenë shumë të rënda nëse ky subjekt rivlerësimi do të vazhdojë të bëjë të njëjtat gabime nga ana profesionale në të ardhmen.

1.9 **Sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016:** *“1. Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsye-timit ligjor; 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.”*

2. **Nga analizimi i procedimit penal nr. ***, datë 28.3.2014**, ndaj të pandehurit A. D., për kryerje të veprës penale “Mashttrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, për të cilën është vendosur dërgimi i procedimit penal për gjykim, në datën 23.12.2014, unë, si anëtar në pakicë, konstatoj se:

2.1 Akti procedural, “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale”, është përpiluar dhe nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, z. Artan Shtrungza, në datën 23.12.2014.

2.2 Përmbajtja e aktit nuk është e strukturuar mirë, pasi pjesa më e madhe nuk është e ndarë në paragrafë dhe në shumicën e rasteve nuk janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, si dhe ka shumë gabime gramatikore.

2.3 Interpretimi ligjor dhe cilësimi juridik i veprës nuk është i përcaktuar në dokumentin e përgatitur nga ana e subjektit të rivlerësimit pasi duke analizuar dispozitën e parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, ajo ka disa paragrafë me masa dënimi të ndryshme.

2.4 Në aktin e njoftimit të akuzës ndaj të të pandehurit A. D., nuk është specifikuar se në bazë të cilit paragraf të nenit 143 të Kodit Penal, është akuzuar i pandehuri.

2.5 Konstatohet se edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë e ka dënuar të pandehurin A. D., për kryerje të veprës penale “Mashttrim” parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, pa specifikuar në bazë të cilit paragraf të këtij neni. Por referuar masës së dënimit të kërkuar nga prokurori dhe të dhënë nga gjykata prej 6 muajsh burgim, si dhe masës së dënimit të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 143 (gjobë ose burgim deri në 5 vjet), konkludohet se si prokurori, ashtu edhe gjykata, kanë aplikuar paragrafin e parë të këtij neni.

2.6 Duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, konstatohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale të mashtrimit nëpërmjet shumë episodeve, si dhe në vlerë totale prej 3,5 milionë lekësh. Në këto rrethana, duke u nisur si nga numri i episodeve, ashtu edhe nga pasoja e rëndë e shkaktuar të dëmtuarit (3,5 milionë lekë), subjekti i rivlerësimit duhet ta kishte akuzuar të pandehurin sipas paragrafit të dytë, të nenit 143 të Kodit Penal.

2.7 Konkretisht, në datën 28.3.2014, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet urdhrorit datë 28.3.2014, ka urdhëruar regjistrimin në regjistër të emrit të shtetasit A. D., si person nën hetim për veprën penale të mashtrimit. Më tej, subjekti i rivlerësimit, 9 muaj më vonë, me vendimin datë 27.9.2014, ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit për 3 muaj, prej datës 28.9.2014 deri në datën 28.12.2014.

2.8 Me vendimin e datës 22.12.2014, prokurori ka vendosur dërgimin për gjykim të të pandehurit A. D. Në këto rrethana, konstatohet se për periudhën nga data 28.6.2014 deri në datën 28.9.2014, nuk është marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimit, në kundërshtim me kërkesat e neneve 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale.

2.9 Subjekti i rivlerësimit, gjatë shpjegimeve të tij me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore pranoi se ka pasur një cilësim të gabuar të veprës penale.

2.10 Si konkluzion në lidhje me këtë procedim të subjektit të rivlerësimit, arrij në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore dhe procedurat hetimore brenda afatit kohor të përcaktuar në nenet 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale;
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar cilësim juridik të veprës penale për të pandehurin, të papërcaktuar qartë në kërkesën për gjykim dhe të gabuar, nëse i referohemi vendimit të gjykatës në masën prej 6 muajsh. Për pasojë, ka ardhur një vendim i gabuar i gjykatës.
- iii. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka ndarë dokumentin e përgatitur në paragrafë dhe në shumicën e rasteve nuk janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe ka shumë gabime gramatikore.

2.11 Në lidhje me vlerësimin e shumicës së trupit gjykues se: “Nga analizimi i dosjes hetimore rezulton se veprimet e subjektit nuk kanë patur për qëllim favorizimin e të pandehurit, por kanë ardhur si pasojë e ngarkesës në punë. Kjo ngarkesë vërtetohet edhe nga statistikat e përgatitura për hedhjen e shortit për përzgjedhjen e dosjeve, sipas të cilës rezulton se vetëm gjatë vitit 2014, subjekti ka patur në ngarkim 192 çështje, që janë pothuajse gjysma e ngarkesës për të gjithë periudhën trevjeçare të rivlerësimit. Këto pasaktësi të kryera nga subjekti i rivlerësimit në këtë procedim penal për sa kohë nuk kanë sjellë pasojë të rënda apo shumë të rënda nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkimin e tij.”, unë çmoj se ngarkesa në punë, siç thashë dhe më lart, nuk

duhet të mbizotërojë mbi cilësinë profesionale, veçanërisht në kualifikimin e gabuar të veprës penale në mënyrë të përsëritur.

2.12 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këto mangësi të konstatuara, gjatë seancës dëgjimore deklaroi se: “... dhe për këtë procedim penal, si në rastin e procedimit nr. ***, ka pasur arsyetim të gabuar dhe cilësim të gabuar të veprës penale për të dy, por dhe në këtë rast ai e justifikon me ngarkesën e madhe në punë gjatë kësaj periudhe...”, unë, si anëtar kundër, vlerësoj se ky shkak i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nuk justifikon mangësitë e tij në fushën e interpretimit dhe të arsytimit ligjor.

2.13 Sipas pikave 1, 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016:

*“1. Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsye-timit ligjor;
2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën;*

3. Aspekti i arsytimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit.”

3. Procedimi penal nr. *, datë 31.10.2014,** në ngarkim të shtetasit F. Q., për kryerje të veprës penale “Vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal, për të cilin është vendosur pushimi i çështjes penale në ngarkim të këtij shtetasi në datën 17.12.2015. Po në të njëjtën datë 17.12.2015, subjekti i rivlerësimit, ka urdhëruar regjistrimin e emrit të autorit të cilit i atribuohet vepra penale, duke e zëvendësuar emrin e F. Q., me emrin e H. M. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të këtij procedimi, unë, si anëtar në pakicë, konstatoj se:

3.1 Akti procedural “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale” është përpiluar dhe nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, z. Artan Shtrungza, në datën 28.12.2015.

3.2 Përmbajtja e akteve të përgatitura nga subjekti i rivlerësimit nuk është e strukturuar mirë, pasi pjesa më e madhe nuk është e ndarë në paragrafë dhe në shumicën e rasteve nuk janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, si dhe ka shumë gabime gramatikore në dokumente.

3.3 Në pjesën konkluduese të kërkesës për gjykim, subjekti i rivlerësimit ka arritur në përfundimin se hetimet e kryera janë të plota, ekzistojnë prova të mjaftueshme për ngritjen e akuzës; cilësimi juridik i veprës penale për të cilat është akuzuar i pandehuri është ai i parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal dhe se çështja duhet të dërgohet për gjykim. Me aktin e datës 17.12.2015, janë pushuar hetimet në ngarkim të shtetasit nën hetim F. Q.

3.4 Ndërkohë që gjatë gjykimit të çështjes, në konkluzionet përfundimtare, subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se vepra penale për të cilën duhet të dënohet i pandehuri është ajo e parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal. Edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë ka vlerësuar, ashtu si prokurori, që i pandehuri ka kryer dhe duhet të dënohet për veprën penale të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal. Procesi gjyqësor është zhvilluar me procedurën e posaçme të gjykimit të shkurtuar dhe ndryshimi i qëndrimit në lidhje me akuzën ndaj të pandehurit është pasqyruar në konkluzionet përfundimtare të prokurorit.

3.5 Nuk janë respektuar kërkesat e neneve 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me afatet e hetimit.

3.6 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se kërkesa për dënim për veprën penale të parashikuar nga neni 137/1 dhe jo nga neni 137/2 i Kodit Penal është një lapsus në shkrim gjatë përpilimit të konkluzioneve, pasi qëllimi i prokurorit ka qenë për dënimin e të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal.

3.7 Në datën 31.10.2014, subjekti i rivlerësimit, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. *** në ngarkim të shtetasit F. Q., si person nën hetim për veprën penale të parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal. Hetimet në ngarkim të këtij shtetasi kanë vazhduar deri në datën 17.12.2015, datë në të cilën është vendosur pushimi i hetimeve në ngarkim tij.

3.8 Konstatohet se, në kundërshtim me kërkesat e neneve 323 dh e 324 të Kodit të Procedurës Penale, në fashikullin e këtij procedimi penal nuk u gjet asnjë vendim për zgjatjen e afatit të hetimit, në ngarkim të shtetasit të sipërpërmendur. Referuar periudhës së shtrirjes së hetimit në ngarkim të shtetasit F. Q., subjekti i rivlerësimit, në zbatim të kërkesave të neneve 323 e 324 të Kodit të Procedurës Penale, duhej të kishte vendosur zgjatjen e afatit të hetimit në periudha 3-mujore, duke filluar nga data 31.1.2015 (kur ka mbaruar afati 3-mujor) deri në datën e pushimit të hetimit në ngarkim të këtij shtetasi.

3.9 Në lidhje me këtë procedim të subjekti të rivlerësimit arrij në përfundimin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar ndryshimin e qëndrimit të tij për cilësimin juridik të veprës penale, nga kërkesa për gjykim dhe të gjitha aktet e dosjes ku ishte shënuar neni 137/2 i Kodit Penal në vend të nenit 137/1 gjatë gjykimit të çështjes;
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer procedurat hetimore brenda afatit kohor të përcaktuar në nenet 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale;
- iii. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka ndarë dokumentin e përgatitur në paragrafë; në shumicën e rasteve nuk ka respektuar rregullat e drejtshkkrimit, dhe dokumenti ka shumë gabime gramatikore.

3.10 Në lidhje me shpjegimin e subjektit të rivlerësimit se është një lapsus në shkrim gjatë përpilimit të konkluzioneve, unë vlerësoj se ky nuk është lapsus, por interpretim i gabuar i ligjit në raport me faktet dhe me rrethanat e çështjes.

4. Denoncimi publik nr. *** prot., datë 30.4.2019, i ardhur në Komision nga z. M. K., në lidhje me zvarritjen e procedimit penal nr. ***, të vitit 2018

4.1 Më datë 30.4.2019, pranë Komisioni të Pavarur të Kualifikimit ka ardhur një denoncim nga z. M. K., i cili e akuzon subjektin e rivlerësimit për shkelje ligjore, duke pretenduar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë ka regjistruar procedim penal të kallëzimit të shtetasit M. U., ndaj shtetasit M. K., dhe se regjistrimi i procedimit penal është bërë në kundërshtim me ligjin, pasi shtetasja M. U., për të njëjtat fakte ka bërë disa kallëzime penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

4.2 Në të gjitha rastet është vendosur mosfillimi i hetimit si dhe disa prej tyre kanë marrë formë të prerë më vendim gjykate. Ndërkohë që kjo shtetase është dërguar si e pandehur në gjykatë për veprën penale të kallëzimit të rremë. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë nuk është kompetente për hetimin e kësaj çështjeje, pasi të gjitha faktet kanë ndodhur në Kukës.

4.3 Më tej, denoncuesi thotë se ka dyshime se procedimi po zvarritet për të favorizuar shtetasen M. U.

4.4 Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se në datën 6.4.2018, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar kallëzimin penal për veprim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

4.5 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë / subjekti i rivlerësimit me urdhrin e datës 11.4.2018, ka urdhëruar regjistrimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2018, për veprën penale “Vetëgjyqësi”, sipas nenit 277 të Kodit Penal.

4.6 Në datën 2 maj 2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore për hetimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2018, kohë kur i ishte njoftuar denoncimi nga Komisioni.

4.7 Në datën 26 prill 2019, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht për procedurën e rivlerësimit.

4.8 Në këto rrethana, konstatohet se për periudhën nga data 11.4.2018 deri në datën 2.5.2019, nuk është marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimit, në kundërshtim me kërkesat e neneve 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale.

4.9 Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit deklaroi se vonesa në marrjen e vendimit nga ana e tij kishte të bënte me veprimet hetimore komplekse për të provuar se kishte veprë penale apo jo, apo nëse kjo veprë kishte ndodhur në Tropojë apo jo. Por subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion veprimet hetimore që ai kishte ndërmarrë për këtë rast.

4.10 Në lidhje me këtë procedim të subjekti të rivlerësimit arrij në përfundimin se:

4.11 Subjekti i rivlerësimit nuk i ka kryer procedurat hetimore brenda afatit kohor të përcaktuar në nenet 323 dhe 324 të Kodit të Procedurës Penale.

4.12 Nuk ka marrë vendim për zgjatje të afatit të hetimeve sipas nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale.

4.13 Ka zvarritje të marrjes së vendimit për shpallje të moskompetencës për një kohë të gjatë, më shumë se një vit, duke mos respektuar asnjë afat ligjor të parashikuar në Kodin e Procedurës Penale.

4.14 **Në lidhje me deklarin e subjektit gjatë seancës dëgjimore** se vendimmarrja është vonuar, pasi veprimet hetimore kanë qenë komplekse, unë vlerësoj se sado komplekse të ishin këto veprime, nuk justifikojnë zvarritjen e çështjes deri në datën 2.5.2019, kohë kur ai ishte vënë në dijeni të këtij denoncimi.

Konkluzioni përfundimtar në lidhje me vlerësimin profesional

Nga analiza e të metave të konstatuara më lart në shqyrtimin e pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një shorti objektiv dhe rastësor, si dhe informacionit të marrë nga denoncimi i shtetasit M. K., unë, si anëtare në pakicë/kundër, vlerësoj aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit referuar germës “b”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, duhet të konsiderohen me mangësi, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët dhe nuk është efektiv.

Këto mangësi të konstatuara vlerësoj se mund të plotësohen duke ndjekur programin e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës për një periudhë 1-vjeçare, duke pasur parasysh se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë trajnim vazhdues, nuk ka përfunduar shkollën e magjistraturës. Ky program mund të kontribuojë në mënyrë thelbësore në rritjen e aftësive profesionale të subjekti të rivlerësimit.

Nuk jam dakord me vendimin e shumicës se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar kriterin e parashikuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016: “...ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.”, por referuar pikës 3, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës; pikës 1, të nenit 60, të ligjit nr. 84/2016; si dhe neneve 73, 74, 76 të ligjit nr. 96/2016, vlerësoj se duhej të vendosej pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit për një periudhë 1-vjeçare, pasi janë evidentuar mangësi në aftësitë e tij profesionale, të cilat mund të plotësohen.

ANËTAR

Etleda Çiftja